



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1928/ 1 prot.,

Datë 21.07.2025

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt Loti 1 “Blerje mish viçi, mish pule, vezë” me Nr. REF-48324-05-20-2025, me fond limit: 11,810,000 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind dhjetë mijë) lekë pa TVSH ose 119,972 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) Euro, kursi kembimit 98, 44 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 20.05.2025, zhvilluar në datën 30.06.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK me NIPT K73609801E me adresa: Fshati Kanaparaj, Ura Leshniqës, Golem, Kavajë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nene Tereza” Nr. 492 Kamëz, Tiranë.

Në datë 18.07.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2025/5574 dhe me nr. 1928/2025 Prot., date 18.07.2025 e operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt Loti 1 “Blerje mish viçi, mish pule, vezë” me Nr. REF-48324-05-20-2025, me fond limit: 11,810,000 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind dhjetë mijë) lekë pa TVSH ose 119,972 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) Euro, kursi kembimit 98, 44 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 20.05.2025, zhvilluar në datën 30.06.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK:

- Subjekti “KAZAZI” SHPK, skualifikohet, pasi nuk plotëson kriterin 2.3.1, të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor por edhe bazuar në nenin 77, pika 4 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën dhe për këtë kërkojnë fatura me produkte të ngjashme.

Subjekti “KAZAZI” SHPK duhet të ketë përvojë në shitjen e produkteve të ngjashme me produktet e objektit të procedurës të cilat janë:

-Mish viçi;

-Mish pule;

-Vezë.

Në faturat e ngjashme të dorëzuara nga operatori ekonomik “KAZAZI MEAT”, vihet re se ky operator ka dorëzuar fatura me produktet: (mish viçi, mish pule, nënprodukte mishi etj) dhe për dy produktet e para ka demonstruar se ka eksperiencën e nevojshme. Për sa i përket produktit “vezë”, një nga produktet e objektit të kontratës ky operator bazuar në faturat e ngjashme të dorëzuara nuk ka demonstruar të ketë shitur asnjë kokërr vezë të vetme përgjatë 3-viteve të fundit, çka do të thotë që ky operator ekonomik nuk ka përvojën e duhur për të zbatuar kontratën për këtë artikull pavarësisht se nga nevoja ka arritur të lidhë një kontratë furnizimi më vezë. Produkti vezë nuk ka produkt të ngjashëm mishin e viçit apo të pulës apo të produkteve të sallamit, të cilat ky operator ka paraqitur për të plotësuar kriterin.

Së dyti: data e vendosur në ofertën ekonomike Shtojca 1, faqe e parë është data 20.03.2025, datë e cila është jashtë afateve të procedurës në fjalë (e cila është shpallur me datë 21.05.2025), prandaj formulari ofertës konsiderohet i pavlefshëm.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 21.07.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro